



qendra e provimeve

SHIFRA E NXËNËSIT

PROVIMI I MATURËS

GUSHT 2017

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

U D H Ë Z I M

KOHA PËR ZGJIDHJE TË TESTIT ËSHTË 180 MINUTA

Gjatë testit nuk lejohet përdorimi i pajisjeve elektronike.
Nxënësi/nxënësja nuk guxon në asnjë mënyrë ta zbulojë identitetin e vet në test ose t'i drejtohet vlerësuesit në mënyrë të drejtpërdrejtë.
Testi **DUHET** të zhvillohet me laps kimik i cili nuk mund të fshihet.

Testi përmban detyra në të cilat do të përgjigjeni në njërin prej këtyre mënyrave:

- duke rrethuar numrin para përgjigjes së saktë
- duke shkruar një përgjigje të shkurtër
- duke shkruar një përgjigje më të gjatë
- duke shkruar ese

Me testin ke marrë edhe **fletën e përgjigjeve** për detyrat me zgjedhje të shumëfishtë.

Nevojitet që në vendin përkatës me kujdes t'i përshkruash përgjigjet tua.

Detyra do të vlerësohet me (0) pikë nëse:

- është e pasaktë
- janë rrethuar më shumë përgjigje të ofruara
- është e palexueshme dhe e paqartë
- zgjidhja është shkruar me laps të thjeshtë

Nëse gabon vendos një vijë të kryqëzuar mbi të dhe detyrën zgjidhe përsëri. Kur ta përfundosh zgjidhjen e testit, kontrolloji edhe njëherë përgjigjet tuaja. Me fat!

Me fat!



* A 8 0 8 8 0 *

FAQE E ZBRAZËT

LULE NGA MAJAKOVSKI

Historia më e prekshme në jetën e Vlladimir Majakovskit ka ndodhur në Paris, kur është dashuruar në Tatjana Jakovleva.

Ata nuk kishin asgjë të përbashkët. Emigrantja ruse, e formuar, e perfeksionuar dhe e edukuar në vargjet e Pushkinit dhe Tjutçevit, nuk kuptonte asnjë fjalë nga vargjet e copëtuara, të ashpra, të shkëputura të poetit modern të sovjetit “akullthyesit” nga Bashkimi Sovjetik. Në esencë ajo nuk kuptonte asnjë fjalë të tij, madje as në jetën reale. I egër, i tërbuar, i pa rezervë, duke jetuar me frymëmarrjen e fundit, ai e frikësonte me pasionet e shfrenuara të tij. Nuk e prekte as besnikëria e tij, nuk e fascinonte as fama e tij. Zemra e saj mbeti e paprekur. Edhe Majakovski u kthye vetëm në Moskë. Nga kjo dashuri e rrufeshme dhe e pamundur atij i mbeti një hidhërim i fshehtë, kurse ne kënga e çuditshme “Letra Tatjanës Jakovleva” me fjalët: “Përkundër të gjithave një herë do të fitoj – vetëm ose së bashku me Parisin!” Asaj i mbetën lulet. Të gjithë honorarin nga shfaqja në Paris Vlladimir Majakovski e deponoi në bankë në llogari të një firme të njohur të luleve në Paris me një kusht që disa herë gjatë javës t’i dërgojnë Tatjana Jakovlevës buqeta me lulet më të bukura – hortensia, manushaqe, trëndafila, orkide ose krizantema. Kompania me renome e Parisit i plotësonte mirë udhëzimet e klientit ekstravagant – dhe që atëherë pa marrë parasysh rrethanat kohore dhe stinët e vitit, nga viti në vit në derën e Tatjana Jakovlevës trokite furnizuesi me buqeta me një frazë të vetme: “Nga Majakovski.”

Majakovski ka vdekur në vitin 1930 – ai lajm e kishte shtangur. Tashmë ishte mësuar në atë që ai rregullisht të hynte në jetën e saj, tanimë ishte mësuar me dijeninë se ai ishte diku atje dhe i dërgonte lule. Nuk takoheshin, mirëpo fakti se ekzistonte njeriu, i cili e donte aq shumë, ndikonte në të gjithë atë që ndodhte. Nuk dinte madje as si të jetonte më tej – pa atë dashuri të çmendur, të dëshmuar me lule.. Mirëpo, në udhëzime që i kishte lënë poeti i dashuruar kompanisë së luleve, nuk bëhej fjalë për vdekjen e tij. Të nesërmen në pragun e saj u paraqit furnizuesi me një buqet lulesh shumë të bukura dhe me të njëjtat fjalë: ” Nga Majakovski.”.

Thuhet se dashuria e madhe është më e fuqishme se vdekja, por gjithkush nuk ka sukses që ta përjetojë këtë deklaratë në jetën reale. Vlladimir Majakovski ia kishte dalë. Lule sillnin edhe në vitin ’30 kur kishte vdekur, edhe në vitet dyzet, kur tashmë ishte harruar. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, gjatë okupimit gjerman të Parisit ajo arriti të mbijetojë vetëm se shiste në bulevard ato buqeta të bollshme të luleve. Pasi që çdo lule ishte “një dashuri”, tekstualisht për disa vite radhazi fjalët e tija të dashurisë e kishin shpëtuar nga uria. Më pas forcat aleate e kishin çliruar Parisin, pastaj së bashku me të tjerët qante nga gëzimi kur hynë rusët në Berlin – kurse buqetat i arrinin edhe më tej. Furnizuesit plakeshin para syve të saj, i zëvendësonin të rinjtë, ndërkohë që të gjithë dinin se ishin një pjesë e legjendës së madhe – vogël, por të rëndësishme. Dhe tashmë si një parullë, e cila u jep kalim në përjetësi, flisnin, duke qeshur me një buzëqeshje komplotiste: “Nga Majakovski.”

Lulet nga Majakovski u bënë në Paris tashmë një histori. A është e vërtetë apo një shpikje e bukur? Një herë në fund të viteve të shtatëdhjeta, një inxhinier sovjetik Arkadij Rivlin, i cili e kishte dëgjuar këtë rrëfim në rini nga nëna e tij, ishte në Paris.

Tatjana Jakovleva ende ishte gjallë dhe me kënaqësi e priti bashkëvendësin e vet. Biseduan gjatë për gjithçka duke pirë çaj dhe hëngër ëmbëlsira. Në atë shtëpi komode lule kishte gjithandej – si një nderim për legjendën, e kishte pakëndshëm ta pyeste damën e thinjur mbretërore për romancën e saj të rinisë: mendonte se do të ishte e papërshtatshme. Por në një moment, nuk mundi të duronte, e pyeti nëse është e vërtetë ajo që flasin se lulet nga Majakovski i kishin shpëtuar jetën gjatë luftës. A është kjo një përrallë e bukur? A është e mundshme që aq vite...

“Pini çajin, pini çajin. A nxitoni diku?”, tha Tatjana.

Dhe në atë moment në derë u dëgjua zilja... Asnjëherë në jetën e tij nuk kishte parë një buqetë të tillë të bollshme pas të cilës mezi shihej furnizuesi, buqeta me krizantema të arta japoneze, të cilat ngjanin në klasterët e diellit. Dhe pas asaj buqete të madhe dhe të shkëlqyeshme u dëgjua zëri i furnizuesit i cili tha: “Nga Majakovski”.

(Përgatitur nga burimi i CdM-së, publikuar më, 23. 03. 2017)

1. Për çfarë dalloheshin Majakovski dhe Tatjana Jakovleva?

2 pikë

2. Në çfarë mënyre Majakovski e tregonte dashurinë ndaj Tatjana Jakovlevës?

2 pikë

3. Përse thuhet në tekst se Majakovski është një klient ekstravagant?

1. Për shkak të pasionit të tij të shfrenuar ndaj Tatjanës.
2. Sepse Tatjanës i kishte shkruar: “Një herë do të fitoj – vetëm ose së bashku me Parisin”.
3. Për shkak se të gjithë honorarin nga shfaqja në Paris e shpenzoi në lule për Tatjanën.

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

4. Rrethoje PO nëse mendon se konstatimi është i saktë, kurse JO nëse konsideron se konstatimi nuk është i saktë dhe arsyetoje përgjigjen.

KONSTATIMI	PO	JO	ARSYETIMI I PËRGJIGJES
Për shkak të dashurisë së pakthyer Majakovski i dëshpëruar u kthye në Moskë.	PO	JO	
Dashuria e Majakovskit e shpëtoi Tatjanën në kohën e Luftës së Dytë Botërore.	PO	JO	
Miku i Majakovskit, Arkadij Rivlin, e vizitoi Tatjana Jakovlevën.	PO	JO	

2 pikë

5. Në pyetjen e Arkadi Rivlinit nëse rrëfimi për lulet të cilat arrijnë nga Majakovski është një përrallë e bukur, Tatjana thoshte: “Pini çaj, pini çaj”. A nxitoni diku?” Shpjegoje përse përgjigjeje ashtu.

1 pikë

REMBRANDTI – PËRVOJA E PAFUND

Duke ngritur kokën, djaloshi shkurt u kthye në një rën anë. Floku i tij kaçurrel, i bukur binte mbi ballë dhe qafë. Buzët e ndjeshme janë pak të hapura, vetullat të ngritura. Me lëvizje fytyrën e fut në rreze të dritës, të cilat bien në anën e majtë të supit të tij. Mbi jakën e bardhë të tij, fytyra dhe maja e hundës për një çast janë të ndriçuara. Shikimi nga hija përpiqet me atë të shikuesit, nuk ndalet në te, sikur është bërë i vetëdijshëm për diçka, sikur diçka kërkon. Shprehja e sinqertë e fytyrës duket i humbur në mendime, i dorëzuar botës rreth vetes. Edhe pse me një format të vogël, piktura zbulon një lojë shumë të efektshme të dritës dhe elementëve të errët. Hedhja e ngjyrave është e ndryshueshme, e zbutur me kujdes me kalime të dukshme, krahas veprimeve spontane me penel, gërvishtje, njolla dhe me pika.

(Michael Bockemühl, REMBRANDT (1606 – 1669), Misioni i formës së zbuluar, Podgoricë, 2007)

6. Teksti i dhënë është:

1. interpretim i pikturës
2. komentim i tekstit letrar
3. komentim gazetaresk

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

7. Me cilin stil funksional është shkruar teksti i dhënë?

1. publicistik
2. letrar - artistik
3. shkencor - popullor

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

8. Si quhet përshkrimi i dhënë në artin figurativ dhe letrar?

1 pikë

9. Përshkruaji nga teksti fjalitë të cilat kanë të bëjnë me përdorimin e teknikës së pikturimit.

1 pikë

10. Përcaktoje klasën e fjalëve të nënvizuara në fjalitë e mëposhtme.

Herë pas here, tek zbrisnin, gjenerali kthente kokën pas.
Konturet e tyre bëheshin më abstrakte, më pak kërcënuese.
Vetura kaloi nëpër udhën me baltë.

tek _____

pas _____

kërcënuese _____

nëpër _____

2 pikë

11. Foljen e mëposhtme ktheje nga forma veprorë në formën joveprorë duke ruajtur vetën, numrin, kohën dhe mënyrën.

Do të pëlqesh.

1 pikë

Lexoje poezinë „Mall” dhe përgjigju në pyetjet 12, 13, 14, 15 dhe 16.

Ca pika shiu ranë mbi qelq
për ty unë befas ndjeva mall.
jetojmë të dy në një qytet
dhe rrallë shihemi sa rrallë.

Edhe m'u duk pak e çuditshme
si erdh kjo vjeshtë, ky mëngjes,
qiejt e ngrysur pa lejlekë
dhe shirat pa ylber në mes.

Dhe thënia e vjetër e Heraklitit
seç m'u kujtua sot për dreq:
“Të zgjuarit janë bashkë në botë,
kurse të fjeturit janë veç”.

Në ç'ëndërr kemi rënë kaq keq,
që dot s'po zgjohemi ne vallë?...
Ca pika shiu ranë mbi qelq
dhe unë për ty seç ndjeva mall.

Ismail Kadare

- 12.** Shikoj dy vargjet e para të strofës së parë dhe dy vargjet e fundit të strofës së fundit dhe përgjigju çfarë ndryshimi është mes tyre?

1 pikë

- 13.** Cili është motivi që e përshkon këtë poezi?

1 pikë

- 14.** Çfarë efekti krijon fjala *qelq* në vargun: “*Ca pika shiu ranë mbi qelq*”?

1 pikë

15. Në cilin prej vargjeve të mëposhtme sintaksa poetike vjen me rend të përmbysur?

1. Ca pika shiu ranë mbi qelq
2. Për ty befas ndjeva mall
3. Kurse të fjeturit janë veç

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

16. Vjeshta në strofën e dytë është figurë stilistike e:

1. alegorisë
2. krahasimit
3. simbolit

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

Lexoje fragmentin në vijim dhe përgjigju në pyetjet 17, 18, 19, 20 dhe 21.

- Eja të përqafoj, moj Dritëzë e mirë, që më dhe këtë lajm të bukur!
Domethënë pa rrezik!

- E kapërceu! Për pak ditë ngrihet. Eja, eja vemi ta shohim.

Profesori e zuri nga krahu. E nderonte dhe e çmonte shumë Dritën, këtë vajzë të vetme shqiptare që ish dalluar në tërë infermieret! Profesori kish marrë vesh se Gori ish plagosur rëndë, prandaj la Albacetën dhe erdhi gjer këtu. Gjatë rrugës mendonte shumë. Ishte shqetësuar tepër, prandaj gjatë gjithë udhëtimit nuk e mbante vendi! Gorin e kishte pasur nxënës në gjimnaz dhe e kish njohur mirë. Ndaj e deshi. Kur e kish parë n'Albacetë bashkë me Dragush Vjosarin, kish mbetur një copë herë pa lëvizur, pastaj, si e ka zakon ai, kur entuziazmohet flet pak fjalë dhe hesht. „Ja dhe dy shqiponja shqiptare në Spanjën e ndezur!“ Dhe i kish përqaftuar me lot ndër sy nga gëzimi. I kish pasur nxënës. U kish folur në klasë me atë zë të tij si kushtrim, i kish ndezur, i kish bërë të urrenin regjimin e shtypjes. U kish folur edhe mënjanë. Gorin e kish ndihmuar edhe ekonomikisht, se profesori rogën e tij ua ndante nxënësve të varfër. E deshi siç deshte tërë nxënësit e tij, tërë të rinjtë e Shqipërisë që po mprihnin shpatat e çlirimit. Dhe kur e pa në frontin e lirisë, ndjeu krenari dhe mburrje! Andaj tani e deshi edhe më shumë. Andaj me të marrë lajmin, përnjëherësh la çdo punë dhe erdhi me gjak të ngrirë për të parë nxënësin e tij, vullnetar të lirisë. Andaj edhe e përqafoi Dritën, kur i tha se Gori s'ka rrezik. Andaj tani e shtrëngon nga krahu dhe të dy i drejtohen shtratit të Gorit.

17. A) Shkruaje titullin e veprës nga e cila është marrë ky fragment.

1 pikë

B) Kush është autori i veprës?

1 pikë

18. A) Tema e kësaj vepre është marrë nga lufta qytetare e:

1. Francës në vitin 1936
2. Italisë në vitin 1936
3. Spanjës në vitin 1936

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

B) Cili është subjekti i veprës dhe çka paraqitet në të?

2 pikë

19. Për çka u fliste në klasë profesor Tomori nxënësve të tij?

1 pikë

20. Profesor Tomori interesohej për:

1. Dritën
2. Gorin
3. Pucellin

Rrethoje numrin para përgjigjes së saktë dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve. 1 pikë

21. Cilit lloj të prozës i takon kjo vepër?

1 pikë

22. Shpjegoje shprehjen frazeologjike *bie perdja*.

1 pikë

23. Shkruaji me shkronja numrat:

17 _____

21 _____

600 _____

1911 _____

2 pikë

24. A) Nënvizojë fjalën e shkruar drejtë.

çbëj shbëj zhbëj

1 pikë

B) Shkruaje shkallën sipërore të fjalës I NGADALSHËM.

1 pikë

25. A) Shënoji presjet atje ku duhet të jenë.

Ai foli me ta edhe për kohën e mirë edhe për mbjelljet e kryera edhe për dëborën e parë edhe për duhanin.

1 pikë

B) Shpjegoje përdorimin e presjes në shembullin e dhënë.

1 pikë

26. Në bazë të fragmentit nga vepra shkruaje emrin e veprës dhe autorin e saj.

- Pa dëgjoni, ju, o shërbëtorë. Sot pas mesdite t'u hipni kuajve e të vini sindonja njëzet veta ndë rezet të malit Tomorrit, atje tek të dëgjoni krismën e pushkëvet, që të na shërbeni e të na ngarkoni gjahun që kemi për të bërë, ndë dashtë Zoti e të na sbardhë armetë.

1 pikë

Që ditën që vdiqe, që kur s'të kam parë,
lotët që kam derdhur s'më jan' edhe tharë!
Shumë vjet u bënë, sot u mbushën dhjetë,
që kur më ke lënë dhe s'të shoh në jetë!

1 pikë

Në këtë qytet të "bardhë"
me mija gurbetqarë...

NATA

Lugut t'qiellit fluturojnë retë hijerënda
vedrat e territ tue derdhë mbi rrugët e
plasaritura –

Nata e errët horizontet i mbylli...

Qiella tash bahet si çerep'i zi...

dhe pikat e para t'shiut

hovshëm lëshohen mbi rrugë e pullaze.

1 pikë

27. Pranë titullit të veprës letrare shkruaje gjininë letrare të cilës i përket.

Arnaut Osmani dhe Hyso Radoica _____

Antigona _____

Iliada _____

Sheshi i unazës _____

2 pikë

28. Nënvizojë emrin e shkrimtarit i cili i përket realizmit.

Françesko Petrarka, Honore de Balzak, Sofokliu, Lermontovi

1 pikë

29. Rrethojë numrin para nocionit që ka të bëjë me romantizmin dhe zgjidhjen barte në fletën e përgjigjeve.

1. objektivizmi
2. mistifikimi
3. racionalizmi

1 pikë

30. Janë ofruar dy tema për hartimin e esesë. Rrethojë numrin para temës që do ta zhvillosh. Eseja duhet të përmbajë 250 deri në 300 fjalë.

Hartoje atë si tërësi që duhet të ketë hyrjen, zhvillimin dhe përfundimin. Respekto kërkesën për numrin e fjalëve +/-10% (vlerësohet punimi që ka 225 deri në 330 fjalë; nëse eseja ka më pak se 225 fjalë NUK LEXOHEM FARE, kurse në fjalën e 330-të NDËRPRITET leximi).

Gjatë hartimit të esesë kujdes për mënyrën e të shprehurit dhe për zbatimin e normave drejtshkrimore. Shkruaj lexueshëm.

1. “HANKO HALLA”, ALI ASLLANI

Udhëzime për shkrimin e esesë.

Shkruaj për:


- Formën letrare që i takon kjo vepër.
- Përbërjen e veprës, temën që trajton ajo.
Subjektin e veprës, personazhet e saj.
- Ndjenjat e kryepersonazhit nga bota që e rrethon, kontaktin e parë dhe të dytë të Hanko Hallës me botën e re.
Veço ndonjë varg që i ilustron këto ndjenja dhe kontaktet e Hallës me botën e re.
Trego si na vjen figura e Hanko Hallës?
- Formën dhe strukturën e vargut, rimën, figurat themelore dhe mbështetjen ku gjejnë ato.
Pakënaqësitë brenda kësaj vepre, të cilat kthehen në një konflikt brezash, midis të resë dhe të vjetrës. Jep ndonjë shembull ilustrues.
- Karakterin e Hanko Hallës dhe mësimin moral që na jep kjo vepër.

2. MIQËSIA NUK ZGJEDHET, AJO NDODH, KUSH E DI PËRSE, SI DASHURI.

Udhëzime për shkrimin e esesë.

- Përshkruaje rëndësinë e miqësisë në jetën e një njeriu.
- Numëroji disa virtyte të cilat vlejnë për një shoqëri dhe miqësi të sinqertë.
Përshkruaje virtytin të cilin posaçërisht e veçon dhe e çmon te një mik.
- Përshkruaje portretin e jashtëm dhe të brendshëm të shokut më të mirë/të shoqes më të mirë. Cilit portret i jep përparësi? Shpjegoje përse.
- Jefe qëndrimin tënd për miqësinë e sinqertë.
- Në përfundim shpjegoje titullin e temës.

25 pikë



2.

2.

3.

3.

4.

4.

5.

5.

6.

6.

7.

7.

8.

8.

9.

9.

10.

10.

11.

11.

12.

12.

13.

13.

14.

14.

15.

15.

0

1

2

3

4

5

6

7

8

9

0

1